



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:173561
Datë: 11.03.2024
Numri i dokumentit: 05435095

Ac.nr.1238/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dardan Kadolli, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Hunaida Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit, adresa: rr. “Lidhja e Pejës”, Prishtinë, kundër të paditurit Sh. (H.) H., adresa: Zabel i Ulët, Komuna Drenas, përfaqësuar nga A. H., avokat në Drenas, për rimbursim të dëmit, duke vendosur sipas ankesës të paditurit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë Dega në Drenas, C.nr.174/2018, i datës 25.01.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditësit Sh. H., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogoc, C.nr.174/18, datë 25.01.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.174/2018, i datës 25.01.2022, ka vendosur si në vijim: aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë, rruga “Lidhja e Pejës”, pn, ashtu që DETYROHET i padituri Sh. H. H. nga fshati Zabeli i Ulët, Komuna e Glllogocit, që paditëses t’ia kompensojë shumën prej 7,693.00 €, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 22.11.2015, në Glllogoc, me kamatën ligjore prej 8 % nga dita kur është parashtruar padia e deri në pagesën definitive si dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën prej 60 €, e gjitha këto në afatin prej 7 ditëve nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kanosjen e përmbarimit ligjor.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i të paditurit në afat ligjor ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, si dhe vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, me propozim gjykatës së shkallës së dytë që të prishë aktgjykimin e atakuar dhe lënda të kthehet në rigjykim e rivendosje.

Në shkresa të lëndës nuk mund të gjendet se pala e paditur ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e të paditurit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se pala paditëse përmes të autorizuarit të saj me datë 31.05.2018 ka paraqitur padi për rimbursimin e dëmit, lidhur me aksidentin e datës 22.11.2015, kundër të paditurit, i cili ishte drejtues i automjetit F. P., me targa të regjistrimit ..-814-BP, pa regjistrim dhe i pa siguruar. Ai nga pakujdesia i kishte shkaktuar dëme të dëmtuarit S. S., F., S., E., O. S. dhe B. Sh.. Të dëmtuarit në fjalë kanë bërë kërkesë të pala paditëse për kompensim të dëmit, me ç' rast pala paditëse ia ka pranuar të drejtën në kompensim për të njëjtit në lartësi prej 7693.00€, për të cilin kompensim palët kanë lidhur pajtim jashtëgjyqësor me datë 18.03.2013.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave, si dhe vlerësimit të tyre, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësit.

Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka dhënë vlerësimin se është arritur të provohet se me datë 22.11.2015, kishte ndodhur aksident i komunikacionit me fajin e drejtuesit të automjetit fiat punto, Sh. H. i cili në momentin e aksidentit nuk ka pasur mbulesë siguroese, e në të cilin aksident ishin lënduar drejtuesit e veturave Sh. H. dhe S. S. si dhe pasagjerët F. S., S. S., E. S. dhe B. Sh.. Faktin se i padituri ka qenë fajtor ishte vërtetuar me aktgjykimin penal të kësaj gjykate P.340/2016 të formës së prerë me datë 22.11.2016 i cili në momentin e aksidentit nuk kishte as mbulesë siguroese. Paditësja bazuar në dispozitat e Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autiopërgjegjësia, të dëmtuarve në procedurë jashtëgjyqësore i kishte kompensuar për dëmin material dhe jomaterial si pasoj e lëndimeve të pësuarra në aksident dhe atë të dëmtuarit S. S. për dëmin material për veturë në shumën prej 3,319.00€, ndërsa familjes Saliuku për dëmin material dhe jo material dhe shpenzimet e avokatit, si pasoj e lëndimeve të pësuarra i kishte kompensuar shumën prej 3,631.00€, kurse të dëmtuarit B. Sh. i kishte kompensuar shumën prej 528€ si dhe për shpenzimet e avokatit shumën prej 215 apo bashkërisht shumën prej 743€, e të gjitha këto së bashku në shumë të përgjithshme prej 7,693.00€.

Më tej ka arsyetuar se paditësja ka të drejtë që të kërkojë rimbursimin e dëmit nga i padituri të cilin dëm ia kompensuar të dëmtuarve sepse i padituri në ditën e aksidentit nuk ka pasur mbulesë siguroese dhe se aksidenti është shkaktuar me fajin e tij, fakt të cilin nuk e ka kontestuar as i autorizuari i tij.

Gjykata e Apelit e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k), dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndron pretendimet ankimor për konstatimin e gabuar të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor. Gjykata përmes raportit të aksidentit 2015 AR 2992 të datës 22.11.2015, ka vërtetuar mënyrën e ndodhjes së aksidentit, i cili kishte ardhur derisa vetura "A" (Fiat Punto) ishte duke lëvizur nga drejtimi i Komoranit për në drejtim të Glllogocit dhe kur arrin në fshatin Zabel të Ultë nuk e përshtat shpejtësinë e lëvizjes së automjetit që drejtonte me kushtet e rrugës pasi që në atë moment kishte të reshura atmosferike dhe rruga ishte e lagur, kalon në shiritin tjetër dhe godet veturën "B" (VW Golf), i cili ishte duke lëvizur në drejtim të kundërt ku si pasojë e këtij aksidenti lëndime pësojnë dy drejtuesit e automjeteve Sh. H.dhe S. S. si dhe pasagjerët F. S., E. S., S. S. dhe O.. Po ashtu përmes Aktgjykimit P.nr.340/16 i datës 25.10.2016, është vërtetuar se i padituri ishte shpallë fajtor për aksidentit e shkaktuar, në të cilin aktgjykim është vërtetuar se palët që paditësja kishte kompesuar, kishin pësuar lëndime trupore. Më tej, në shkresa të lëndës ka dëshmi se se është arritur ujudi për komiesimin e dëmit material në automjet një lartësi 3319.00€, po ashtu me secilën nga palët e dëmtuara. Gjithashtu në shkresat e lëndës gjenden dëshmi për urdhërtransferin bankar. Është vlerësim i kësaj gjykate se pretendimet e të paditurit në këtë fazë të procedurës janë të pabazuara pasi që ato nga pala e paditur nuk janë vërtetuar me asnjë provë. Gjykata e shkallës së parë bazuar në propozimet e palëve ka administruar provat, po ashtu nga përmbajtja e tyre ka vërtetuar gjendjen faktike, në këtë mënyrë nuk është gjetur se gjykata të këtë vërtetuar gabimisht gjendjen faktike, apo ndonjë fakt me rëndësi të mos e këtë vërtetuar fare.

Bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar drejtë, gjykata e shkallës së parë ka arritur që të bëjë kualifikimin në harmoni me të drejtën materiale. Gjykata e Apelit vlerësoi pretendimin ankimor në mënyrën e elaboruar nga pala ankuese, për sa i përket aplikimit të së drejtës materiale, ndonëse për këtë gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, duke gjetur si pretendim të pa bazuar, ngase gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar të njëjtën. Kjo gjykatë gjen se në kuptim të nenit 18 par. 1 të Ligjit nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia përcaktohet se: *Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i auto përgjegjësive, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja*. Kurse në paragrafin 4 të nenit 18 të njëjtë ligj parashihet se: *"Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat"*. Rrjedhimisht paditësja ka të drejtë të kërkojë regres nga shkaktari i dëmit i cili nuk kishte mbulesë siguruese.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, dhe në pajtim me dispozita e LPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit në bazë të nenit nenin 194 dhe 195 par. 1 pika d) lidhur me nenin 200 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
Ac.nr.1238/2022, datë 11.03.2024

Kryetari i Kolegjit, Gjyqtari
Dardan Kadolli